

KAPITULLI I KATËRT

**FILLIMI I MISIONIT
BOTËROR**

Të ndjekësh vullnetin e Zotit pa menduar për veten



Sapo u lirova nga burgu Sodemun, shkova në tempullin budist në malin Gierjung në Provincën Çung-Çong. Kisha nevojë të shërohesha nga plagët e torturave në burg. Gjithashtu, kisha nevojë për një pyll, ku të lutesha dhe të mendoja për të ardhmen e kishës sonë. Nuk kishte shumë që kishte mbaruar Lufta Koreane, kështu që të siguroje ushqim për të mbijetuar ishte shpesh një detyrë e vështirë. Pavarësisht nga këto vështirësi të çastit, ishte e rëndësishme të bëja plane afatgjata. Nuk kishim ende një kishë të madhe ku të mblidheshin të gjithë anëtarët tanë për shërbesa, por e ndjeva që ishte e rëndësishme të shpenzoja pak kohë duke parë drejt së ardhmes së largët.

Pas rënies së sundimit kolonial të Japonisë dhe çlirimit të Koresë, më 1945, këto dy vende ende nuk kishin vendosur marrëdhënie diplomatike. Japonia nuk e kishte njohur qeverinë e Seulit dhe Koreja e konsideronte Japoninë një komb armik. Besoja se, po të merrej parasysh situata e botës, ishte e rëndësishme që këto dy vende të rivendosnin kontaktet. Ishin bërë një sërë tentativash për të dërguar misionarë në Japoni, por ato qenë të pa suksesshme. Në fund, qe Bong Çun Ço që e përmbushi këtë detyrë.

Më 1958, e thirra Bong Çun Çonë të më takonte në malin prapa tempullit Gabsa. “Duhet të shkosh menjëherë në Japoni. Nuk do të kthehesh

në Kore pa pasur sukses”, i thashë.

“Po!” u përgjigj ai, pa hezituuar.

Pas kësaj, të dy kënduam himnin e krishterë korean, fjalët e të cilit janë:

Të thirrurit e Zotit, e nderojmë thirrjen;

Zot, ne do të shkojmë kudo që të na thuash.

Zbritëm nga mali, të dy me një shpirt të lartë. Ai nuk pyeti kurrë si do ta mbante veten në Japoni, apo se si supozohej t’i fillonte veprimtaritë atje. Bong Çun Ço ishte një burrë kaq guximtar. Udhëtimi për në Japoni ishte i ndaluar për shumicën e koreanëve. E vetmja mundësi ishte, që ai të përpiquej të hynte në Japoni pa vizë fare. Do t’i duhej të duronte shumë gjëra.

Bong Çun Ço as që e dinte nëse do të ishte në gjendje të hynte në Japoni apo jo, por ai ishte i përgatitur, nëse do të ishte e nevojshme, të jepte edhe jetën. Derisa mora vesh që kishte kaluar shëndoshë në Japoni, lashë çdo lloj pune dhe u ula të lutesha në një dhomë të vogël të kishës. As haja, as flija. Madje, na u desh të merrnim një kredi prej 1.5 milion uon për ta dërguar atje. Kishim shumë anëtarë që nuk kishin çfarë të hanin, por ungjillëzimi i Japonisë ishte aq i rëndësishëm, sa gjithçka tjetër duhet lihej mënjanë.

Fatkeqësisht, Bong Çun Ço u arrestua sapo mbërriti në Japoni. Ai u fut në burg; në fillim në Hiroshima dhe më pas në Jamaguçi, derisa të mund të kthehej përsëri në Kore. Në burg vendosi më mirë të vdiste se ta kthenin, prandaj filloi të agjërojë. Gjatë agjërimit e kapi një temperaturë e lartë. Autoritetet japoneze vendosën ta çojnë në spital dhe ta shtyjnë kthimin e tij, derisa shëndeti i tij të përmirësohej. Ndërsa ishte në spital, arriti të arratiset nga arresti.

Pas këtyre përpjekjeve, duke rrezikuar jetën për një vit e gjysmë, Bong Çun Ço themeloi kishën në Japoni, në tetor 1959. U desh të kalonin edhe gjashtë vite të tjera që Koreja dhe Japonia të vendosnin marrëdhëniet

diplomatike. Në fakt, Koreja, ngaqë e kishte akoma të freskët kujtesën e dhimbjes e të vuajtjes nën sundimin kolonial japonez, refuzonte çdo sugjerim që të fillonte kontaktet me Japoninë. E dërgova misionarin tonë të hynte kontrabandë në këtë vend armik për hir të së ardhmes së Koresë. Në vend që të refuzonte kontaktet, Koreja kishte nevojë të ungjillëzonte Japoninë, në mënyrë që të vihej në pozitën për të qenë partnere e denjë në marrëdhëniet dypalëshe. Koreja ishte varfëruar materialisht, prandaj nevojitej të hapej një kanal për t'u lidhur me udhëheqjen japoneze, ta bënte për vete Japoninë dhe pastaj të lidhej me Shtetet e Bashkuara. Vetëm kështu mund të mbijetonte Koreja. Si rezultat i përpjekjeve të suksesshme për të dërguar një misionar në Japoni, falë sakrificës së Bong Çun Ço, u bashkua me kishën një udhëheqës rinor tepër i veçantë, i quajtur Osami Kuboki, së bashku me një grup të rinjsh që e ndiqnin. Kisha japoneze hodhi rrënjë të forta si rezultat i punës së tyre.

Ne dërguan misionarë në Amerikë, vitin që pasoi. Këtë herë nuk kishte problem vizash. Ata qenë në gjendje të merrnin pasaportat dhe vizat para se të largoheshin. Për pasaportat na ndihmoi një ministër i kabinetit të Partisë Liberale, që kishte pasur gisht në burgosjen time në Sodamun. Më parë na kishin kundërshtuar, por tani ishin duke na ndihmuar.

Shtetet e Bashkuara në atë kohë dukeshin si komb shumë, shumë i largët. Disa nga anëtarët tanë kundërshtuan idenë për të dërguar misionarë atje, duke thënë se ishte më e rëndësishme të forconim, më parë, themelet këtu në Kore. Megjithatë i binda anëtarët për rëndësinë e dërgimit të misionarëve në Amerikë, duke u thënë se, po të mos zgjidhet kriza e Amerikës, edhe Koreja mund të shkatërrohej. Në janar 1959, ne dërguam atje Jong Oon Kim, një nga profesorët që ishte pushuar nga universiteti i vajzave "Iuha". Pastaj, në shtator të po atij viti, dërguam David S.C. Kim. Puna që ata filluan në Amerikë synonte të përfshinte tërë botën.

Para të fituara me nder dhe të shpenzuara me pastërti



Fondet e grumbulluara nga investimet në biznes janë të shenjta. Sidoqoftë, që përfitimet e biznesit të jenë të shenjta, është e rëndësishme të mos gënjesht dhe të mos marrësh fitim të tepruar. Kur drejtojmë një biznes, ne duhet të jemi gjithmonë të ndershëm dhe nuk duhet të marrim kurrë një përfitim më të madh se 30 për qind. Paratë e fituara në mënyrë të ndershme, natyrisht, duhet të shpenzohen me pastërti. Duhet të shpenzohen me një qëllim dhe një synim të qartë. Ky është parimi i administrimit të biznesit që e kam përkrahur gjatë gjithë jetës sime. Unë besoj se qëllimi i biznesit nuk është thjesht fitimi i parave. Qëllimi i biznesit është të mbështesë punën misionare, e cila është punë e Zotit.

Një nga arsyet pse kam punuar të krijoj fonde për punë misionare nëpërmjet biznesit është, se nuk doja të merrja para nga anëtarët për këtë qëllim. Sado i lartë të jetë qëllimi, dërgimi i misionarëve jashtë vendit nuk mund të arrihej thjesht duke e dëshiruar atë gjë. Nevojiteshin fonde. Këto fonde duhet të fitoheshin në emër të kishës. Fondet për punën misionare duhet të fitoheshin në mënyrë të ndershme. Vetëm atëherë ne mund të jemi krenarë për gjithçka kemi bërë.

Duke studiuar variante të ndryshme për të nxjerrë para, më vajti syri

te pullat e postës. Në ato kohë u sugjeroja anëtarëve t'i shkruanin njëri-tjetrit, të paktën, tri herë në muaj. Postimi i një letre kushtonte 40 uon, por u sugjeroja të mos vendosnin thjesht një pullë 40 uon në letrat e tyre. Në vend të saj, u sugjeroja të përdornin dyzet pulla, 1 uon secila. Ne i morëm pullat e përdorura nga letrat, i shitëm dhe arritëm të bënim 1 milion uon vitin e parë. Duke parë që ato pulla poste të përdorura, të cilat dukeshin të pakuptimta, mund të sillnin një fitim të madh prej koleksionistëve të tyre, anëtarët e vazhduan këtë punë për shtatë vjet. Shisnim gjithashtu edhe foto bardhë e zi të vendeve të njohura, ose të personaliteteve të njohura të artit, që i kishim ngjyrosur me dorë. Edhe ky biznes kontribuoi në mënyrë domethënëse në zhvillimin e veprimtarive të kishës sonë.

Me rritjen e kishës, pullat e postës dhe fotografitë e ngjyrosura nuk mjaftonin për të nxjerrë fondet, që na duheshin për punën misionare. Na duhej ta ngrinin biznesin në një nivel më të lartë, nëse do të dërgonim misionarë në të gjithë botën. Në vitin 1962, para se qeveria koreane të rivlerësonte monedhën e saj, ne blemë një torno që ishte përdorur nga japonezët, por ishte braktisur në vitin 1945, për 720,000 uon. Pas rivlerësimit ajo vlente 72,000 uon. Monedha koreane ishte e varur nga dollari amerikan, asokohe me vlerë 125 uon, kështu që vlera zyrtare e investimit ishte 576 \$. E vendosëm këtë torno në një dhomë ku magazinionim briketat e qymyrit në shtëpinë “pronë e armikut”, që e përdornim si kishë dhe e quajtëm “Industritë Tongil”.

“Ndoshta ju duket e pavlerë kjo torno,- shpjegova unë.- Ju mund të habiteni duke menduar se çfarë lloj biznesi do të bëjmë duke instaluar një makinë të vjetër dhe të përdorur. Megjithatë, kjo makinë që shikoni këtu do të shumëfishohet brenda një kohe të shkurtër në 7000 dhe, madje, në 70 000 torno, dhe kompania do të zhvillohet përkrah industrisë koreane të mbrojtjes dhe asaj të automobilave. Kjo makinë, që instaluam sot, do të

jetë me siguri guri i themelit për ndërtimin e industrisë së automobilave në kombin tonë. Kini besim. Kini bindjen se kjo do të ndodhë me siguri”.

Kështu u fola atyre që ishin mbledhur përpara derës së dhomës ku magazinoheshin briketat e qymyrit. Ishte një fillim modest, por qëllimi ynë ishte shumë i lartë dhe fisnik. Ata iu përgjigjën thirrjes sime dhe punuan me dedikim. Si rezultat i kësaj, në vitin 1963 ne qemë në gjendje të fillojmë një tjetër biznes në një shkallë disi më të gjerë. Kjo përfshiu ndërtimin e anijeve të peshkimit. Barka u lëshua në ujë në një mol në rajonin e Mansok Dong, në Inçon, dhe u pagëzua me emrin “Çon Sëng Ho”, që do të thotë “Barka Fitorja e Qiellit”. Rreth dyqind vetë ndoqën ceremoninë, gjatë së cilës kjo barkë peshkimi u lëshua në det. Uji është burimi i jetës. Ne të gjithë kemi lindur prej barkut të nënës. Brenda atij barku ka ujë, pra, ne jemi lindur nga uji. E lëshova atë barkë në ujë me besimin që, ashtu siç e marrim jetën nga uji, është e nevojshme të dalim në det dhe të kalojmë një sërë provash, për t’u bërë të aftë të mbijetojmë në provat që do të hasim në tokë.

“Çon Sëng Ho” ishte një barkë e jashtëzakonshme. I ra detit të Verdhë kryq e tërthor dhe kapi shumë peshq, edhe ose shumë vetë reagues duke thënë, se ne kishim mjaftueshëm për të bërë në tokë dhe se nuk ishte nevoja të dilnim në det e të kapnim peshk. Mirëpo, e ndieva se bota ishte gati për të hyrë në një epokë oqeanike. Lëshimi në ujë i barkës “Çon Sëng Ho” ishte një hap i vogël, por i çmuar; hapi i parë në hapjen e asaj epoke. Isha, tashmë, duke e imagjinuar në mendje detin e gjerë mbushur me anije më të mëdha dhe më të shpejta se “Çon Sëng Ho”.

Fuqia e vallëzimit mallëngjen botën



Ne nuk ishim një kishë e pasur. Ishim një kishë e varfër, e filluar nga njerëz që nuk kishin ushqim të mjaftueshëm për të ngopur barkun. Nuk kishim ndërtesa luksoze, si kishat e tjera, por hanim elb, kur të tjerët hanin oriz, dhe i kursenim paratë pak e nga pak. Pastaj i ndanim ato para me njerëzit që ishin më të varfër se ne. Misionarët tanë flinin në dhoma të ftohta, duke shtruar një jorgan mbi dyshtemenë prej çimentoje. Kur vinte ora e ngrënies, përgjithësisht, e trembnin urinë duke ngrënë pak patate të ziera. Në çdo rast, bënim çmos të mos i shpenzonim paratë për veten.

Në vitin 1963 i përdorëm paratë, që kishim kursyer në këtë mënyrë, për të zgjedhur 17 fëmijë dhe formuam trupën e baletit të fëmijëve, që u quajt “Engjëjt e Vegjël”. Koreja ato kohë kishte shumë pak shfaqje kulturore. Nuk kishim asgjë për të parë dhe për t’u argëtuar as për veten tonë, lëre pastaj ndonjë gjë për t’ia prezantuar popujve të vendeve të tjera. Të gjithë ishin aq të zënë duke u përpjekur që të mbijetonin, sa që nuk mbanin mend si ishin vallet koreane, apo dhe faktin që ne kishim një trashëgimi kulturore, që shkonte pesë mijë vjet më parë.

Plani im ishte t’u mësoja këtyre shtatëmbëdhjetë fëmijëve si të vallëzoinin dhe, pastaj, t’i dërgoja ata nëpër botë. Shumë të huaj e njihnin Korenë vetëm si një vend i varfër, që kishte kaluar një luftë të tmerrshme. Doja

t'u tregoja atyre vallet e bukura të Koresë, në mënyrë që ta kuptonin që populli korean është një popull me kulturë. Ne mund të ngulnim këmbë sa të donim, që ishim një popull me një kulturë dhe traditë pesëmijë-vjeçare, por askush nuk do ta besonte, nëse nuk do të kishim se çfarë t'u tregonim.

Vallet tona, me valltarët e veshur në hanboks-e të bukura dhe të gjata, që rrotullohen lehtë, janë një trashëgimi kulturore e mrekullueshme, e cila mund t'u japë një përjetim të ri perëndimorëve, që janë mësuar të shohin valltarë që hidhen e përdridhen gjysmë të veshur (hankok është veshje koreane tradicionale për gra). Vallet tona janë të mbushura me historinë e mjeruar të popullit korean. Lëvizjet e vallëzimit korean, gjatë të cilit valltarët e mbajnë kokën paksa të ulur poshtë dhe lëvizin me kujdes, sikur të mos duan të tërheqin vëmendjen ndaj vetes, u krijuan nga populli korean, historia pesëmijë vjeçare e të cilit është e mbushur me dhimbje e pikëllim.

Kur valltarja ngre njërën këmbë të mbështjellë me *bosonin* e bardhë (çorape tradicionale koreane) dhe e çon përpara për të bërë një hap të vetëm, ajo e kthen kokën ngadalë dhe ngre dorën. Ndërsa shikoj mprehtësinë fisnike të lëvizjeve të saj, duket sikur të gjitha shqetësimet dhe zhgënjimet e zemrës më treten dhe shkojnë. Nuk ka përpjekje për të prekur audiencën me shumë fjalë dhe me zë kumbues. Në vend të tyre, çdo lëvizje e interpretuar me fisnikëri dhe mprehtësi të madhe prek zemrat e audiencës. Kjo është fuqia e artit. Lejon njerëzit, që nuk kuptojnë gjuhën e njëri-tjetrit të komunikojnë. Lejon njerëzit që nuk njohin historinë e njëri-tjetrit, të kuptojnë zemrën e njëri-tjetrit.

Në veçanti, shprehjet e fytyrave të pafajshme dhe buzëqeshjet e shndritshme të fëmijëve do të jenë me siguri në gjendje të fshijnë tërësisht imazhin e errët të një vendi që, pak kohë më parë, ka qenë në luftë. Unë e krijova këtë trupë vallëzimi që t'i prezantoja vallet nga historia jonë

pesëmijë vjeçare të vendit tonë njerëzve në Shtetet e Bashkuara, që ishte vendi më i zhvilluar i botës në atë kohë. Megjithatë, shoqëria përreth e ashpërsoi kritikën ndaj nesh. Filluan të kritikojnë, madje, edhe pa i parë ende vallet e “Engjëjve të Vegjël”.

“Gratë e Kishës së Unifikimit kërcejnë ditë e natë”, deri këtu shkoi kritika fyese, “dhe tani duket sikur kanë lindur edhe fëmijë që kërcejnë në atë mënyrë”. Sidoqoftë, asnjë nga këto thashetheme nuk do të lëkundte vendosmërinë time. Isha i vendosur t’i tregoja botës se si ishin vallet koreane. Doja t’u mundësoja njerëzve që na akuzonin se kishim kërcyer lakuriq, të shihnin lëvizjet e bukura dhe fisnike të valltareve, që shkelnin butësisht me çorapet e tyre koreane. Këto nuk ishin vallëzime të egra, me hedhje e përdredhje pa ritëm. Ato ishin vallëzime fisnike, nga valltarë të dëlirë, të veshur me rrobat tradicionale të vendit tonë.

Engjëjt hapin një shteg në mes të pyllit të errët



Ka dy gjëra që duhet t'ua lemë pasardhësve kur të vdesim. Një është tradita dhe tjetra është arsimimi. Një popull pa traditë do të dështojë. Tradita është shpirti që lejon një popull të vazhdojë; një popull pa shpirt nuk mbijeton dot. Gjëja e dytë e rëndësishme është arsimimi. Një popull, po ashtu, do të dështojë nëse nuk i arsimon pasardhësit e tij. Arsimimi na jep fuqinë të jetojmë me dije dhe objektiva të reja. Në sajë të arsimimit, njerëzit fitojnë mençuri për të jetuar. Ai që nuk di të lexojë do të mbetet injorant, por, pasi të edukohet, njeriu do të dijë si ta përdorë këtë mençuri për të administruar jetën e tij. Arsimi na ndihmon të kuptojmë parimet me të cilat bota funksionon. Për të hapur një të ardhme të re, është e nevojshme, nga njëra anë, të transmetojmë tek pasardhësit traditën, që na është lënë për më shumë se mijëra vjet, dhe nga ana tjetër, t'i furnizojmë edhe me njohuritë për gjërat e reja. Kur tradita dhe njohuritë e reja integrohen siç duhet në jetën tonë, ato i japin jetë një kulture të origjinale. Tradita dhe arsimi janë të dyja të rëndësishme, prandaj është e vështirë të thuash se cila është primare dhe cila është sekondare. Edhe zgjuarsia për t'i integruar ato vjen nga arsimimi.

Në kohën që themelova trupën e valltarëve, themelova edhe shkollën artistike të “Engjëjve të vegjël” (më vonë u quajt Shkolla Artistike “Sun-

hua”). Qëllimi për të cilin u themelua kjo shkollë ishte të përhapte idealet tona në të gjithë botën, nëpërmjet artit. Çështja nëse kishim apo jo aftësi të drejtonim një shkollë ishte e dorës së dytë. Së pari vura në praktikë planin tim. Nëse qëllimi është i qartë dhe i mirë, atëherë duhet vënë në praktikë sa më shpejt. Doja të edukoja fëmijët të donin qiellin, të donin atdheun e tyre dhe të donin njerëzimin.

Unë shkrova moton e shkollës në një kaligrafi me shkronja kineze ku thuhej: “Duaj Qiellin, duaj njerëzimin, duaj atdheun”. Dikush më pyeti: “Pse e shkruan ‘duaj atdheun’ në fund, ndërsa thua se qëllimi yt është t’i tregosh botës kulturën unike të Koresë?”

Unë iu përgjigja: “Nëse njeriu do qiellin dhe njerëzimin, ai e ka dashur tashmë vendin e tij. Dashuria ndaj atdheut është brenda atij procesi”.

Nëse një korean bën që bota ta respektojë, atëherë ai tashmë ka përbushur misionin që bota të njohë Korenë. “Engjëjt e vegjël” shkuan në shumë vende dhe treguan shkëlqimin e kulturës koreane, por kurrë nuk bënë ndonjë deklaratë nacionaliste rreth vendit të tyre. Imazhi i Koresë, si një vend me traditë dhe kulturë të madhe, u rrënjos thellë në mendjet e njerëzve, që panë dhe duartrokitën shfaqjet e tyre. Në këtë kuptim, “Engjëjt e vegjël” bënë, më shumë se kushdo tjetër, publicitet në mbarë botën për Korenë dhe vunë në praktikë dashurinë e tyre për atdheun. Kam një kënaqësi të veçantë sa herë shikoj shfaqjet e Su Mi Xho dhe Joung Ok Shin, që janë diplomuar në Shkollën Artistike “Sunhua”, të cilët kanë ecur dhe janë bërë vokalistë të mirënjohur në mbarë botën, si dhe, kur shikoj shfaqjet e Xhulia Mun dhe Sui Xhin Kang, që janë midis balerinëve më të mirë të botës.

Që nga viti 1965, kur dhanë shfaqjen e parë jashtë vendit, në Shtetet e Bashkuara, “Engjëjt e vegjël” kanë prezantuar traditën e bukur të Koresë në mbarë botën. Ata janë ftuar nga familja mbretërore britanike që

të jepnin shfaqje në prezencë të Mbretëreshës Elizabet II. Janë ftuar të marrin pjesë në kremtimin e dyqind vjetorit e Shteteve të Bashkuara, ku dhanë shfaqje në qendrën artistike dhe kulturore “Xhon F. Kenedi”. Ata kanë dhënë një shfaqje të veçantë për presidentin e ShBA-ve, Richard Nixon dhe morën pjesë në festivalin artistik kulturor, pjesë e Lojërave Olimpikë të Seulit. “Engjëjt e Vegjël” njihen në mbarë botën si ambasadorë kulturorë për paqen.

Kjo që do të them tani ka ndodhur në vitin 1990, kur bëra një vizitë në Moskë. “Engjëjt e vegjël” dhanë një shfaqje një natë para se të largohesha nga Bashkimi Sovjetik, pasi kisha takuar presidentin Mikhail Gorbaçov. Vajzat e vogla koreane qëndruan në qendër të Moskës, që ishte qendra e komunizmit. Pasi shfaqën vallet koreane, të veshura në hanboks, “Engjëjt e vegjël” kënduan këngë popullore ruse me atë zërin e tyre të bukur. Thirrjet “biss!” nga audienca e bënë të pamundur daljen e tyre nga skena. Në fund kënduan gjithë repertorin e këngëve të tyre.

Zonja e parë, Raisa Gorbaçov, ishte në mes të dëgjuesve. Koreja e Jugut dhe Bashkimi Sovjetik nuk kishin vendosur akoma marrëdhënie diplomatike, prandaj ishte shumë e pazakontë që zonja e parë të ndiqte një program kulturor nga një vend i tillë. Sidoqoftë, znj. Gorbaçov u ul në rreshtin e parë dhe duartrokiste me entuziazëm gjatë gjithë programit. Pas shfaqjes, erdhi pas skenës dhe i dhuroi trupës lule. Ajo lavdëronte herë pas here madhështinë e kulturës koreane, duke thënë: “Engjëjt e vegjël” janë me të vërtetë engjëjt e paqes. Nuk e dija që Koreja e Jugut kishte një kulturë tradicionale kaq të bukur. Gjatë gjithë shfaqjes, më dukej sikur shikoja një ëndërr të fëmijërisë sime”. Zonja Gorbaçov i përqafoi të gjithë anëtarët e trupës dhe i puthi në faqe duke u thënë: “Engjëjt e mi të Vegjël!”.


Në vitin 1998, “Engjëjt e vegjël” vizituan Penianin, si pjesë e programit të parë, krejtësisht privat, joqeveritar për shkëmbime kulturore dhe dha

tri shfaqje atje. Kërcyen vallen e bukur “Vallja e dhëndrit të vogël” dhe vallen shumëngjyrëshe “Vallja e erashkave”. Sytë e koreanëve të veriut që shikonin shfaqjen u mbushën me lot. Imazhi i një gruaje që qante me dënese në mënyrë të pakontrolluar u kap nga objektivi i një fotografi gazete. Jong Sun Kim, kryetari i Komisionit të Paqes së Koresë së Veriut, Azisë dhe Paqësorit i lavdëroi “Engjëjt e vegjël” pas shfaqjes, duke thënë: “Ata kanë hapur një shteg të ngushtë në mes të pyllit të errët”.

Kjo ishte pikërisht ajo çfarë kishin bërë “Engjëjt e vegjël”. Treguan për herë të parë se koreanët nga Veriu dhe Jugu, që i kishin kthyer shpinën njëri-tjetrit për një kohë kaq të gjatë, ishin në gjendje të mblidheshin në një vend e të shikonin shfaqjet e njëri-tjetrit. Njerëzit, shpesh, mendojnë se politika lëviz botën, por nuk është ashtu. Janë kultura dhe arti ato që lëvizin botën. Është emocioni, jo arsyeja, ai që i godet njerëzit në pjesën më të thellë të zemrës së tyre. Kur zemrat ndryshojnë dhe janë në gjendje të mirëpresin gjëra të reja, rrjedhimisht ndryshojnë edhe ideologjitë dhe regjimet shoqërore. “Engjëjt e vegjël” bënë më shumë se thjesht reklamimin e kulturës sonë tradicionale në botë. Ata hapën shtigje të ngushta midis dy botëve tërësisht të ndryshme nga njëra-tjetra.

Sa herë i takoj “Engjëjt e vegjël”, u them: “Ju duhet të keni zemra të bukura, që të kërceni valle të bukura. Ju duhet të keni zemra të bukura, që të keni edhe fytyra të bukura”. Bukuria e vërtetë është ajo që buron nga brendësia jonë. “Engjëjt e vegjël” kanë qenë në gjendje të prekin zemrat e njerëzve në mbarë botën, sepse bukuria e traditës dhe kulturës shpirtërore koreane është mishëruar në vallet. Pra, duartrokita që u jepet “Engjëjve të vegjël” është duartrokitje për kulturën tradicionale koreane.

Turneu botëror



Që kur kam qenë fëmijë, mendja ime gjithmonë ka ëndërruar për vendet e largëta. Në vendlindje, i ngjitesha malit dhe më merrte malli për detin. Kur arrija në Seul, doja të shkoja në Japoni. E kam pasur gjithmonë ëndërr të shkoja në vende më të mëdhaja se ai ku isha.

Në vitin 1965 fillova udhëtimin tim të parë rreth botës. E mbusha valixhen me dhë e gurë nga Koreja. Plani im ishte që, gjatë udhëtimit rreth botës, të vendosja dheun dhe gurët e Koresë në çdo vend, që kishte kuptimin e lidhjes së Koresë me botën. Për dhjetë muaj, vizitova dyzet vende, duke përfshirë Japoninë, Shtetet e Bashkuara dhe vende të Evropës. Ditën që u largova nga Seuli, qindra anëtarë erdhën me autobusë për të më shoqëruar dhe mbushën sallën e nisjeve të aeroportit të Kimpo-s. Në atë kohë, dalja jashtë shtetit ishte një ngjarje domethënëse. Anëtarët tanë u grumbulluan në aeroport atë ditë janari me erë të ftohtë, që frynte furishëm nga veriperëndimi. Askush nuk u kishte thënë ta bënin këtë. Ata bënë siç u kishte thënë zemra. Unë e pranova zemrën e tyre me një mirënjohje të thellë.

Në atë kohë, ne kryenim punë misionare në dhjetë shtete, por plani im ishte ta shtrija atë në dyzet shtete brenda dy vjetëve. Pikërisht, që të shtrija themelin për këtë gjë, vendosa të vizitoja dyzet shtete gjatë

udhëtimit tim. Ndalea e parë ishte në Japoni. U mirëprita në mënyrë të jashtëzakonshme atje ku Bong Çun Ço kishte rrezikuar jetën, për të filluar misionin.

I pyeta anëtarët japonezë: “A jeni ‘të Japonisë’, apo e keni kapërcyer stadin e të qenit ‘të Japonisë?’”

Vazhdova: “Zoti nuk do atë që është ‘e Japonisë’. Atij nuk i nevojitet ajo që është ‘e Japonisë’. Ai do njerëz që kapërcejnë Japoninë. Ju duhet të shkoni përtej kufijve të Japonisë dhe të bëheni japonezë që e duan botën, nëse doni të bëheni njerëz që mund të përdoren nga Zoti”.

Mund të mos e kenë pasur të lehtë të dëgjojnë këto fjalë, por u fola shumë qartë.

Stacioni im i dytë ishin Shtetet e Bashkuara. Hyra atje nëpërmjet aeroportit të San Franciskos, ku u takova me misionarët tanë. Që aty vizitua gjithë vendin. Gjatë kohës që vizitoja Amerikën, e ndjeva shumë fort se: “Ky është vendi që udhëheq botën. Kultura e re që duhet të krijohet në të ardhmen duhet të lindë duke pasur si themel Amerikën”. Pastaj bëra një plan për të blerë një qendër seminaresh në Shtetet e Bashkuara që merrte pesëqind veta. Natyrisht, kjo nuk do të ishte vetëm për koreanët. Do të ishte një ndërtesë që do të mirëpriste njerëz nga njëqind vende.

Fatmirësisht, kjo shpresë u realizua shpejt. Shumë vende dërguan njerëz në këtë ndërtesë seminaresh, ku studionin dhe debatonin për paqen botërore për disa muaj rresht. Nuk kishte dallim race, kombësie apo feje. Besoj se bota do të zhvillojë shoqëri më të mira, kur njerëzit që kanë shkuar përtej racës, kombësisë dhe fesë dhe që kanë një shumëllojshmëri mendimesh, mblidhen dhe në mënyrë të paanshme diskutojnë në mënyrë të sinqertë për paqen botërore.

Gjatë turneut në Shtetet e Bashkuara, vizitova çdo shtet, përveç Alaskës dhe Havai-it. Ne morëm me qira një makinë me portobagazh dhe udhë-

tuam ditë e natë. Nganjëherë, shoferi ishte shumë i lodhur. “Dëgjo këtu,- i thosha.- Nuk kemi ardhur këtu për shëtitje. Kemi ardhur për punë të rëndësishme. Duhet të ecim me kujdes.”

Nuk harxhonim kohë të uleshim për të ngrënë. Nëse kishim dy feta bukë, një copë salsiçe dhe disa turshi, atëherë ishte më se e mjaftueshme për një vakt. Kështu e hanim mëngjesin, drekën dhe darkën. Gjithashtu flinim në makinë. Makina ishte banesa jonë, ishte krevati dhe restoranti ynë. Ne hanim, flinim dhe luteshim në atë makinë të vogël. Nuk kishte gjë që s’ë bënim atje. Kisha për të përmbushur një qëllim të veçantë, prandaj ishte e lehtë të duroja disa parehati të vogla fizike.

Pas Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkova në Amerikën Qendrore dhe Jugore dhe pastaj në Evropë. Në sytë e mi, Evropa ishte nën sferën kulturore të Vatikanit. Më dukej se nuk mund t’ia dilnim mbanë në Evropë, pa kuptuar Vatikanin. Madje, edhe Alpet, të cilat supozoheshin që ishin shumë të vështira për t’u ngjitur, dukeshin të pallogaritshme në krahasim me Vatikanin.

Shkova në Vatikan, atje ku katolikët evropianë mblidhen për t’u lutur dhe u luta me një zjarr të tillë, saqë pikat e djersës më rrokulliseshin në faqe. U luta që krishterimi, i ndarë në kaq shumë degë dhe grupime, të mund të unifikohet shpejt. Zoti krijoi një botë, por njerëzit e kanë ndarë atë sipas mendjes së tyre. U binda më shumë se kurrë që këto ndarje duhet të fshihen dhe bota duhet të bëhet një. Nga Evropa shkova në Egjipt e në Lindjen e Mesme dhe e përfundova turneun tim pas dhjetë muajsh.

Kur u ktheva në Seul, valixhen e kisha plot me dhé e gurë nga 120 troje të dyzet kombeve. Kur groposja dheun dhe gurët që kisha marrë nga Koreja, merrja dhe e gurë nga secili prej atyre trojeve të cilat i solla me vete në Kore. E lidha Korenë me këto dyzet kombe, në mënyrë që ta përgatisja për ditën që do të vinte, kur paqja botërore do të realizohet,

duke pasur si qendër Korenë. Fillova përgatitjet për të dërguar misionarë në ato dyzet kombe.

Aeroplani i fundit për në Amerikë



Nga fundi i vitit 1971, shkova përsëri në Shtetet e Bashkuara. Kisha disa detyra që duhet t'i përmbushja patjetër, por nuk qe e lehtë të shkoja atje. Nuk ishte hera e parë që shkoja në Shtetet e Bashkuara, megjithatë duhet të prisja më shumë se zakonisht për të marrë vizën. Disa anëtarë më sugjeruan ta shtyja nisjen, por unë nuk mund ta bëja dot atë gjë. Ishte e vështirë t'ua shpjegoja anëtarëve, por ishte e rëndësishme që unë të nisesha nga Koreja në datën e caktuar. Prandaj vendosa të shkoj njëherë në Japoni dhe të aplikoja për vizën amerikane, ndërsa isha në Japoni. Më duhej ta lija Korenë sa më shpejt.

Dita kur u nisa ishte shumë e ftohtë, por erdhën aq shumë anëtarë për të më përshëndetur, sa jo të gjithë mundën të hyjnë në terminal. Megjithatë, kur erdhi koha të kaloja kontrollin e pasaportave, u zbulua që pasaportës sime i mungonte vula e shefit të seksionit të Ministrisë së Jashtme. Kjo vulë kërkohej si provë që tregonte se qeveria më kishte lejuar të largohesha nga vendi. Për shkak të kësaj, humba avionin në të cilin ishte planifikuar të hipja.

Anëtarët, që kishin bërë përgatitjet për nisjen time, kërkuan falje pa masë, më sugjeruan të kthehesha në shtëpi dhe të prisja derisa ta gjenin shefin e seksionit dhe ta bënin të vinte vulën në pasaportën time. “Jo,- u thashë atyre.- Do të pres këtu në aeroport. Shkoni shpejt dhe merrni vulën.”

Zemra ime ishte në urgjencë të jashtëzakonshme. Ndodhi që ishte

e diel, kështu që shefi i seksionit nuk ishte në zyrë. Por nuk mund t'ia lejoja vetes të shqetësohesha për çështje të tilla. Më në fund, anëtarët tanë shkuan në shtëpinë e shefit të seksionit dhe e bënë të vinte vulën në pasaportën time. Kështu munda të marr fluturimin e fundit të ditës për jashtë Koresë. Atë natë, qeveria deklaroi një gjendje kombëtare të jashtëzakonshme dhe vendosi kufizime të mëdha për qytetarët që do të udhëtonin jashtë Koresë për qëllime private. Unë kisha hipur në avionin e fundit që do të më lejonte të shkoja në Amerikë.

Aplikova për vizën amerikane në Japoni, por përsëri më refuzuan. E zbulova më vonë cili ishte problemi. Qeveria koreane kishte akoma të dhënat sipas të cilave isha arrestuar nga policia koloniale japoneze pak para çlirimit, duke u akuzuar si komunist. Fillimi i viteve '70 ishte koha kur komunizmi po përhapej me egërsi. Deri në vitin 1975 ne kishim dërguar misionarë në 127 vende, por nga katër vendet komuniste ishin prëzënë. Të ungjillëzoje në vendet komuniste në atë epokë mund të të çonte në vdekje. Sidoqoftë, unë nuk u dorëzoja kurrë dhe vazhdova të dërgoja misionarë në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera komuniste.

Misionari ynë i parë në Çekosllovakia mbërriti në vitin 1968. Rreth vitit 1980, ne filluam t'i referohemi misionit tonë në vendet komuniste të Evropës Lindore si "Misioni Flutur". Larva duhet të kalojë një periudhë të gjatë vuajtje, para se t'i rriten krahët dhe të bëhet flutur; edhe ne na dukej se kjo ishte e ngjashme me vuajtjen e misionarëve tanë të fshehtë që punonin në vendet komuniste. Është proces i vështirë dalja e një fluturë nga fshikëza e saj, por, sapo bëhet me krahë, flutura mund të fluturojë kudo që dëshiron. Në të njëjtën mënyrë, ne e dinim që, sapo komunizmi të linte fronin, misionarët tanë do të bëheshin me krahë dhe do të fillonin të fluturonin.

Misionarja Joung Oon Kim, që kishte shkuar në Shtetet e Bashkuara në

fillim të vitit 1959, vizitoi universitetet kryesore të atij vendi për të transmetuar fjalën e Zotit. Gjatë atij procesi ajo takoi Peter Koh, një student gjerman në Universitetin e Kalifornisë në Berkeli; ky i ri vendosi të lërë studimet dhe udhëtoi me anije deri në Rotterdam dhe pastaj filloi punën e tij si misionar në Gjermani. Misionarët për në vendet komuniste të Azisë dërgoheshin nga Japonia. Këta misionarë u desh të dërgoheshin në vende ku jeta e tyre mund të vihej në rrezik, pa bërë asgjë më shumë se një shërbim adhurimi special për të shënuar nisjen e tyre. Kjo më dhimbsej njëllë si atëherë kur e shtytja Bong Çun Ço-n të futej kontrabandë në Japoni, gjatë takimit tonë të fundit në pyllin e pishave prapa tempullit Gabsa. Një prind, të cilit i duhet të shikojë si dënohet fëmija, do të kishte parapëlqyer më shumë ta merrte vetë atë dënim. Do të kisha dashur të shkoja vetë misionar. Zemrën e kisha të përlotur kur dërgoja anëtarë në vende ku do të ndiqeshin dhe, ndoshta, mund të ekzekutoheshin për veprimtari fetare. Pasi kishin ikur misionarët, shpenzoja të shumtën e kohës në lutje. Lutjet e sinqerta ishin gjëja më e mirë që mund të bëja për të mbrojtur jetën e tyre. Puna misionare në vendet komuniste ishte një punë e rrezikshme. Një misionar nuk e dinte kurrë se kur mund të kapej nga Partia Komuniste.

Njerëzit që shkonin misionarë në vendet komuniste nuk mund t'u tregonin as prindërve të tyre se ku po shkonin. Prindërit e dinin mirë rrezikun që i priste në ato vende, prandaj nuk do t'u jepnin kurrë leje fëmijëve të tyre. Gunther Verzer u zbulua nga KGB dhe u dëbua. Në Rumani, ku diktatura e Nikolla Çausheikut ishte në kulmin e pushtetit, policia sekrete ndiqte vazhdimisht dhe përgjonte telefonatat e misionarëve tanë.

Ishte sikur misionarët kishin shkuar në gojë të ujkut. Sidoqoftë, numri i misionarëve që shkonin në vendet komuniste vazhdoi të rritet.

Pastaj, në vitin 1973, ndodhi një incident i tmerrshëm në Çeko-

sllovakia, ku tridhjetë nga anëtarët tanë u arrestuan. Një anëtare, Maria Zivna, humbi jetën në burg në moshën e re, njëzetekatër vjeçare. Ajo ishte martirja e parë, që vdiq ndërsa ishte duke bërë punë misionare në një vend komunist. Vitin që pasoi, një tjetër misionar humbi jetën në burg. Sa herë dëgjoja që ndonjë nga anëtarët tanë kishte vdekur në burg, i gjithë trupi më ngrinte As nuk flisja, as nuk haja dot. As për t'u lutur nuk lutesha dot. Thjesht qëndroja i palëvizur për një farë kohe, i paaftë për të bërë gjë. Ishte sikur trupi më kthehej në gur. Nëse ata nuk do të më kishin takuar mua, ose nuk do të kishin dëgjuar çka u mësoja, nuk do ta kishin gjetur kurrë veten në një birucë të vetmuar burgu dhe nuk do të kishin vdekur kurrë në atë mënyrë. Kur vdiqën, ata vuajtën në vendin tim. Pyesja veten: “A është jeta ime aq e vlefshme, sa të ndërrohet me të tyren? Si do ta marr përgjegjësinë për ungjillëzimin e bllokut komunist, gjë të cilën ata e mbajtën në kurriz në vendin tim?”. Nuk flisja dot. Bija në një pikëllim që dukej sikur s’kishte mbarim, sikur të isha hedhur në fund të detit. Në atë kohë, e pashë Maria Zivnan para meje në formën e një fluturë të verdhë. Flutura e verdhë që ishte arratisur nga burgu i Çekoslovakisë rrihte krahët, sikur donte të më thoshte të bëhesha i fortë dhe të ngrihesha. Duke kryer veprimtari misionare me rrezik të jetës së saj, Maria ishte transformuar me të vërtetë nga një larvë, në një flutur të bukur.

Misionarët që punojnë në situata kaq ekstreme shpesh e kanë marrë zbulesën e Zotit nëpër ëndrra apo vizione. Ata ishin të izoluar dhe nuk komunikonin dot lirshëm me të tjerët, kështu që Zoti u jepte zbulesa dhe u bënte të ditur rrugën që duhet të ndiqnin. Shpesh ndodhte që një misionar i cili kishte pak që kishte rënë për të fjetur, shikonte një ëndërr ku i thuhej: “Çohu shpejt dhe shko diku tjetër.” Ai bënte siç i thanë në ëndërr, veç kur merrte vesh më vonë se policia sekrete kishte kontrolluar vendin ku ai po pushonte. Në një rast tjetër, një anëtar pa një ëndërr në

të cilën, një person që nuk e kishte parë kurrë më parë, erdhi dhe i tregoi si ta bënte punën e tij misionare. Më vonë, kur më takoi mua për herë të parë, thirri: “Ti je personi që kam parë në ëndërr”.

Ja, pra, kështu kam rrezikuar jetën time dhe jetën e anëtarëve tanë për të përmbysur komunizmin dhe për të ndërtuar Mbretërinë e Zotit. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara nuk ma jepnin vizën, sepse dyshonin mos isha komunist. Më në fund, në Kanada, pasi dorëzova materiale që deklaropin se isha antikomunist, munda të marr vizë amerikane.

Arsyeja pse m'u desh të kaloja gjithë këto telashe për të shkuar në Amerikë ishte të luftoja kundër forcave të errëta që kishin sjellë degradimin moral të Amerikës. Lashë Korenë për t'i shpallur luftë forcave të errëta. Në atë kohë, të gjitha problemet e botës: komunizmi, drogat, dekadenca dhe degjenerimi moral ishin përzierë të gjitha në një çorbë ferri. Deklarova: “Kam ardhur në Amerikë si zjarrfikës dhe doktor. Nëse bie zjarri diku, zjarrfikësi duhet të vijë dhe nëse dikush është i sëmurë, shkon doktori dhe e viziton”. Unë isha si zjarrfikësi që kishte ardhur në Amerikë për të shuar flakët e imoralitetit dhe si një doktor që kishte shkuar për të shëruar Amerikën nga sëmundja që e kishte bërë të humbte Zotin dhe të shkonte në buzë të rënies morale. Amerika në fillimet e viteve '70 ishte ngatërruar në luftën e Vietnamit dhe aktivistët protestonin. Ishte një vend me të vërtetë i ndarë. Të rinjtë që kërkonin qëllimin e ekzistencës eksperimentonin me alkool, drogë dhe seks të lirë dhe gjatë këtij procesi po harronin shpirtrat e tyre të përjetshëm. Besimet fetare kryesore, që duhet t'i kishin udhëzuar këta të rinj, nuk po e bënin rolin e tyre. Ato nuk mund t'i ndihmonin ata që t'i jepnin fund endjes së tyre të paqëllimtë dhe që të ktheheshin në mënyrën e duhur të jetesës. Kultura hedoniste dhe materialiste rrënoi shumë të rinj, sepse ata nuk kishin një vend ku të gjenin prehje për zemrat e tyre.

Menjëherë pasi arrita në Shtetet e Bashkuara, bëra një turne duke folur rreth temave: “E ardhmja e krishterimit” dhe “Shpresa e Zotit për Amerikën”. Përballë audiencave të mëdha, unë fola për dobësitë e Amerikës ashtu si askush nuk do të qe në gjendje ta bënte.

Unë deklarova se Amerika ishte themeluar mbi shpirtin puritan dhe ishte zhvilluar e bërë vendi më i fortë në botë vetëm për dyqind vjet, sepse kishte marrë dashurinë dhe bekimin e pakufishëm të Zotit. Ia kujtova audiencave se liria e Amerikës buronte nga Zoti, por sot ajo e kishte flakur Zotin mënjane. “Amerika ka një traditë të madhe,- thashë.- Gjithë çka duhet të bëni është ta ringjallni atë.” Unë shkova në Shtetet e Bashkuara për të rizgjuar shpirtin e Amerikës, për ta shpëtuar nga shkatërrimi, dhe për ta nxituar popullin amerikan që të pendohej dhe kthehej tek Zoti.

E ardhmja jonë lidhet me oqeanin



Ndërsa bëja turne nëpër botë, askush nuk e dinte se po bëheshin plane për të zhvilluar një themel ekonomik në shkallë mbarëbotërore. Me rritjen e kishës dhe me shtimin e numrit të misioneve, sasia e fondeve që na nevojitej për të mbështetur këto veprimtari u rrit në mënyrë dramatike. Kishim nevojë për të ardhura. Ndërsa vizitoja dyzet e tetë shtetet e Amerikës, u mendova shumë në lidhje me llojet e bizneseve që mund të mbështesnin veprimtaritë që kishim planifikuar.

Ajo që më erdhi në mendje ishte se amerikanët hanë mish përditë. Pashë sa ishte çmimi i një lope. Vura re se një lopë, që kushton shumë pak në Teksas, mund të kushtonte disa qindra dollarë në Nju Jork. Por kur pashë çmimin e peshkut ton, zbulova se një ton blufin kushtonte mbi 4000\$. Peshku ton bën mbi 1.5 milionë vezë përnjëherësh, ndërsa një lopë bën vetëm një viç njëherë në vit. Ishte e qartë që kapja e peshkut do të ishte një përpjekje më e mirë për biznes se rritja e gjedhit.

Problemi i vetëm ishte se amerikanët nuk hanin shumë peshk, por japonezët ishin jashtëzakonisht të dhënë pas peshkut ton. Atëherë kishte shumë japonezë që jetonin në Shtetet e Bashkuara, kështu që restorantet e shtrenjta në pronësi të japonezëve e shisnin peshkun ton të gjallë me një çmim të lartë. Gradualisht, disa amerikanë po mësonin ta pëlqenin

peshkun e gjallë, dhe filluan ta shijonin peshkun ton.

Toka ku jetojmë mbulohet më shumë nga deti sesa toka. Shtetet e Bashkuara kanë dy oqeanë, prandaj kanë shumë peshk. Gjithashtu, pas kufirit të 322 km, asnjë shtet nuk mund të ketë pretendime territoriale në oqean. Kushdo mund të shkojë dhe të peshkojë. Që të bënim një fermë ose që të rrisnim gjedh, na duhej të blinim tokë, por oqeanin nuk ishte nevoja ta blinim. E vetmja gjë që na duhej ishte një barkë dhe mund të shkonim aq larg sa të ishte nevoja për të kapur peshk. Oqeani është i mbushur me gjëra për të ngrënë. Gjithashtu, në sipërfaqe të oqeanit ka një industri aktive të transportit detar. Anijet transportojnë gjëra të bëra në vende të ndryshme të botës për t'u shitur diku tjetër. Oqeani është një thesar, që i garanton njerëzimit një të ardhme të ndritshme. Prandaj u them se ata që shqetësohen për të ardhmen e njerëzimit duhet të shqetësohen për oqeanet. Kur ne i duam dhe i ruajmë oqeanet, atëherë ruajmë të ardhme të sigurt.

Ne blemë disa barka në Shtetet e Bashkuara. Ato nuk ishin anije të mëdha që mund të shihen në revista turistike, por ishin barka peshkimi rreth dhjetë-njëmbëdhjetë metra të gjata. Ato barka ishin thujse sa një jaht që nuk pëson aksidente të mëdha. Këto barka u çuan në Uashington, San Francisko, Tampa dhe Alaskë. Ne blemë gjithashtu edhe një vend për riparimin e anijeve.

Ne bëmë shumë studime privatisht. E çuam barkën në një vend dhe matëm temperaturën e ujit. Llogaritnim sa peshk ton kapej çdo ditë dhe i vinim të dhënat në një grafik. Nuk morëm thjesht të dhënat që kishin mbledhur ekspertët më parë; anëtarët tanë dolën vetë në det për të mbledhur informacion. U përdorën si referencë rezultatet e studimeve të bëra nga kërkimet universitare në atë zonë. Përveç kësaj, shkova në ato zona, jetova vetë aty dhe kontrollova situatën vetë. Nuk kishte informacion më

të saktë se ai që kishim mbledhur ne. Kaluam shumë telashe për të bërë këtë kërkim, por nuk e mbajtëm atë për vete, përkundrazi e ndamë atë me industrinë e peshkimit. Ngritëm edhe vende të reja peshkimi. Nëse kapet shumë peshk në të njëjtin vend, sasia e peshkut shteron. Është e rëndësishme të shkosh në zona të reja. Brenda një kohe të shkurtër ne i kishim dhënë një ndikim të madh industrisë së peshkimit të Shteteve të Bashkuara.

Hymë në biznesin e kapjes së peshkut në det të hapur. Ideja jonë ishte që një anije do të dilte në det dhe do të gjuante peshk për, të paktën, gjashtë muaj, pa u kthyer në tokë. Kur anija të mbushej plot, një anije transporti shkonte tek ajo, i merrte peshkun dhe e furnizonte me ushqime dhe lëndë djegëse. Anija kishte pajisje frigoriferike, ku mund t'i ruante peshqit për një kohë të gjatë. Emri i anijes sonë ishte “Shpresa e Re” dhe ishte e famshme si e aftë për të kapur shumë peshk.

E merrja vetë atë barkë dhe kapja peshk ton. Njerëzit shpesh kishin frikë të hipnin në barka. Kur ua sugjeroja të rinjve, reagimi i parë i tyre ishte shpesh frika. “Mua më zë deti”, i dëgjoja të thoshin shpesh. “Vetëm sa të hipi në barkë filloj të turbullohem dhe të ndihem sikur po vdes.” Prandaj hyja vetë i pari në barkë.

Që nga ajo ditë, kam dalë në det me barkë pothuajse çdo ditë, për shtatë vjet. Edhe tani, që jam nëntëdhjetë vjeç, mua më pëlqen të dal në det sa herë kam kohë të lirë. Tani ka gjithmonë e më shumë të rinj që shprehin dëshirën të hipin në barka. Më shumë gra duan ta bëjnë këtë gjë. Në çfarëdo detyre, nëse prijësi e bën i pari, njerëzit e ndjekin. Për pasojë, jam bërë i famshëm si gjuetar i peshkut ton.

Sidoqoftë, do të kishte qenë pa shumë vlerë, nëse do të kishim kapur vetëm peshk ton. Ne duhet të ishim në gjendje ta shisnim atë me çmimin e duhur. Ndërtuam një fabrikë të përpunimit të peshkut ton, dhe madje,

peshkun e shisnim vetë. E vinim tonin në kamionë frigoriferikë dhe dilnim dhe e shisnim. Nëse e kishim të vështirë ta shisnim, atëherë hapnim restorantin tonë të prodhimeve të detit dhe ua shisnim tonin klientëve tanë. Kur filluam të kishim restorantet tanë, njerëzit nuk na mohonin dot.

Shtetet e Bashkuara zotërojnë tri nga katër hapësirat më të mëdha të peshkimit në botë. Tri të katërtat e peshkut botëror jeton në ujërat pranë Shteteve të Bashkuara. Mirëpo, Shtetet e Bashkuara kanë relativisht pak njerëz që peshkojnë, dhe industria e peshkimit në Amerikë është e pazhvilluar fare. Qeveria ka marrë shumë masa për të mbështetur industrinë e peshkimit, por ato nuk kanë pasur ndonjë efekt të madh. Qeveria ofroi të shiste barka me ulje çmimi të konsiderueshëm, me kusht që blerësit t'i përdornin për tre vjet, por vetëm disa e shfrytëzuan këtë shans. Sa të mërzi kjo gjë!

Kur filluam të hedhim para në industrinë e peshkimit, kjo shkaktoi trazira në çdo port që shkonim. Kjo nuk ishte e habitshme duke pasur parasysh se komunitetet zhvilloheshin kudo që investonim ne. Puna jonë, në fund të fundit, ishte të shkelnim botë të reja. Ne nuk bënim thjesht peshkim. Po zgjidhnim shtigje që nuk ishin shkelur nga të tjerët. Sa emocionuese është të jesh pionier i shtigjeve të reja!

Oqeani ndryshon vazhdimisht. Thonë që mendja e njeriut ndryshon nga mëngjesi në mbrëmje, por oqeani ndryshon nga çasti në çast. Ja, pra, pse oqeani është edhe misterioz, edhe i bukur. Oqeani përfaqon gjithçka në qiell dhe në tokë. Avujt e ujit mund të grumbullohen në një vend të veçantë për të formuar retë, ose mund të bëhet shi dhe të bjerë përsëri ku ishte.

Unë jam shumë i dhënë pas natyrës, sepse ajo nuk mashtron asnjëherë. Nëse është e lartë, ulet; nëse është e ulët, ngrihet. Në çdo çast përshtatet me lartësinë për t'u bërë e sheshtë. Nëse ulem me një shkop peshkimi

në dorë, duket sikur kam gjithë kohën e botës. Çfarë ka atje në oqean që na pengon? Kush na ngut atje? Kemi shumë kohë për veten. Gjithë çka na duhet të bëjmë është të vështrojmë oqeanin dhe të bisedojmë me të. Sa më shumë kohë shpenzon njeriu në oqean, aq më i madh do të bëhet aspekti shpirtëror të jetës së tij. Megjithatë, oqeani mund të jetë i qetë një minutë, por shpejt mund të ndryshojë fytyrën dhe të na dërgojë dallgë të mëdha. Dallgë disa herë më të larta se një bojë njeriu do të ngrihen mbi barkë dhe duket sikur do ta gëlltisin. Një erë e fortë do shpojë velën dhe do të bëjë një zhurmë të frikshme.

Por, mendoni rreth kësaj. Edhe kur valët ngrihen lart, edhe kur era e frikshme fryn, peshqit në ujë vazhdojnë të flenë, pa u shqetësuar. E lënë veten në duart e valëve dhe nuk i kundërshtojnë. Kjo është ajo që mësova nga peshqit. Vendosa të mos frikësohesha sado të mëdha të ishin dallgët. I lejoja valët të më merrnin me vete. E bëja veten një me barkën dhe ngriheshim së bashku me to. Kur fillova ta bëj këtë, zemra nuk më dridhej më, sido të ishin dallgët që kisha përballë. Deti ka qenë një mësues kaq i mrekullueshëm në jetën time sa që krijova programin e Sfidës së Oqeanit, për t'i dhënë të rinjve stërvitjen për leadership që u ofron oqeani.

Shpresa ime për një revolucion të ri amerikan



Mikpritja fillimisht e ngrohtë e amerikanëve ndaj meje, filloi të ftohet, madje, të kthehet në armiqësi. Ata pyesnin se si kishte guxim një udhëheqës nga Koreja, një vend i parëndësishëm që mezi kishte mbijetuar nga uria dhe nga lufta, t'u bënte thirrje amerikanëve të pendohen.

Nuk ishin vetëm amerikanët që më kundërshtonin. Reagimi i Ushtrisë së Kuqe japoneze, një grup komunist që kishte lidhje me komunistët ndërkombëtarë, ishte shumë i fortë. Madje, ata u kapën nga FBI, duke u përpjekur të hynin vjedhurazi në qendrat e seminareve në Boston, ku qëndroja shpesh. Kishte kaq shumë tentativa për të më goditur, sa fëmijët e mi nuk shkonin dot në shkollë pa roje personale. Për shkak të kërcënimeve për jetën, flisja matanë një xhami të papërshkueshëm nga plumbat për një farë kohe.

Pavarësisht nga gjithë këto kundërshtime, seria e leksioneve të burrit oriental me sy të vegjël zgjoi gjithmonë e më shumë interes. Njerëzit filluan të dëgjonin mësimet, të cilat ishin tërësisht ndryshe nga ç'ka kishin dëgjuar deri atëherë. Përmbajtja e leksioneve që trajtonin parimet themelore të universit dhe që përpiqeshin të ri-zgjonin shpirtin themelues të Amerikës ishin si ajër i pastër për amerikanët, të cilët kishin rënë në

ferrin e imoralitetit dhe përtacisë.

Amerikanët përjetuan një revolucion të ndërgjegjes në sajë të leksioneve të mia. Të rinjtë filluan të më ndjekin, duke më quajtur “Ati Mun” ose “Reverend Mun” dhe filluan të prisnin flokët e tyre të gjata që u binin mbi shpatulla, të rruanin mjekrat e tyre të lerosura. Kur ndryshon pamja, ndryshon edhe mendja. Kështu që Zoti filloi të hyjë në zemrat e të rinjve, që kishin qenë zhytur në alkool dhe drogë.

Për të ndjekur leksionet, vinin të rinj të ndryshëm që kapërcenin degëzimet e krishterimit. Kur ndërprisja fjalimet për t'i pyetur: “A ka ndonjë presbiterian këtu?”, shumë të rinj ngrinin duart, duke thënë: “Këtu, këtu.” Nëse pyesja: “A ka ndonjë katolik?”, përsëri do të ngriheshin duart. Kur pyesja: “Po baptistë jugorë?”, shumë njerëz do të përgjigjeshin përsëri: “Unë”.

“Pse vini e më dëgjoni mua, në vend që të shkoni të dëgjoni një fjalim në grupin tuaj fetar?,- i pyesja.- Shkoni në shtëpi dhe shkoni në kishat tuaja për të dëgjuar fjalën e Zotit”.

Kur e thosha këtë, audienca përgjigjej: “Ne duam të dëgjojmë reverend Moon!”.

Gjithmonë e më shumë njerëzit filluan të mblidheshin, madje, erdhën disa misionarë të kishave presbiteriane dhe baptiste, duke sjellë me vete të rinjtë e kishave të tyre. Me kalimin e kohës, reverend Mun u bë simboli i revolucionit të ndërgjegjes në shoqërinë amerikane.

U mësova të rinjve amerikanë si të duronin vështirësitë. U mësova me detaje parimin që një person duhet të jetë në gjendje të kontrollojë veten, para se të mund të kontrollojë universin. Mësimet e mia u jepnin frymëzim të ri të rinjve amerikanë, që jetonin në një epokë pështjellimi. Bërtisnin njëzëri në favor të mesazhit tim lidhur me pastërtinë seksuale dhe familjet e vërteta. Pritja ishte aq entuziaste, sa më bënte edhe mua të

djersija nga emocionet dhe gëzimi.

“A doni të mbani kryqin e dhimbjes?- i pyesja.- Askush nuk dëshiron të shkojë në rrugën e kryqit. Zemra juaj mund të dojë të shkojë në atë rrugë, por trupi ju thotë ‘Jo!’ Fakti që diçka është thjeshtë e mirë për t’u parë, nuk do të thotë që është e mirë edhe për zemrën. Ka shumë gjëra që duken të mira, por një ekzaminim i aspektit të tyre të brendshëm tregon që janë të këqija. Nëse e gjeni veten duke kërkuar vetëm gjëra që kënaqin syrin dhe përpiqeni të ndiqni atë rrugë, ju duhet të ndaloni menjëherë dhe të thoni: “kopuk!”. Gjithashtu, nëse ndieni dëshirë të hani vetëm gjëra që i pëlqejnë gojës, ju duhet ta qortoni trupin, duke i thënë: “kopuk” dhe duhet të ndaloni. Ju, të rinj, tërhiqeni nga seksi i kundërt, apo jo? Edhe në këtë rast, ju duhet të veproni me vendosmëri kundër nxitjeve të tilla. Nëse një person nuk e kontrollon dot veten, ai nuk bën dot asgjë në këtë botë. Kini parasysh që, nëse ju shkatërroheni, universi do të shkatërrohet.”

Po u mësoja atyre moton që ndoqa vetë kur isha i ri, e cila ishte: “Para se të kërkoresh të kontrollosh universin, së pari përsos aftësinë për të kontrolluar veten”. Amerika kishte një pasuri të madhe, por ishte fiksuar pas të mirave materiale. Qëndroja në mes të këtij civilizimi material dhe flisja rreth çështjeve të mendjes dhe zemrës. Mendja nuk shihet me sy dhe as nuk mbahet në dorë. Megjithatë, është e qartë që ne kontrollohemi nga mendjet tona. Pa mendjen, ne nuk jemi asgjë. Pastaj flisja për dashurinë e vërtetë, dashurinë e përqendruar në Zot, e cila duhet të udhëheqë mendjen. Thosha se mund të gëzojmë liri të vërtetë, vetëm kur të kemi një kuptim të qartë mbi veten, bazuar mbi themelin e dashurisë së vërtetë dhe kur të jemi në gjendje të ushtrojmë vetëkontrollin.

U mësova atyre vlerën e të punuarit shumë. Puna nuk është vuajtje, por krijim. Arsyeja pse një person mund të punojë gjithë jetën e vet dhe të jetë i lumtur është sepse puna është e lidhur me botën e Zotit. Puna që bëjnë

njerëzit nuk është gjë tjetër veçse marrja e gjërave që ka krijuar Zoti dhe shndërrimi i tyre në forma të tjera. Nëse mendoni se jeni duke bërë diçka për t'ia dhënë Zotit si kujtim, atëherë puna nuk është diçka për të cilën duhet menduar negativisht. Shumë të rinj amerikanë ishin aq të ngopur nga bollëku i jetës që u ofrohej nga kultura materialiste, sa nuk e njihnin gëzimin e të punuarit. Kështu, unë u mësova atyre si të punonin me gëzim.

Gjithashtu zgjova tek ata gëzimin që ndien kur dashuron natyrën. Të rinjtë ishin të kapur në rrjetën e kulturës imorale të qyteteve dhe të skllavëruar në jetën egoiste, kështu që unë u fola rreth vlerës së çmuar të natyrës. Natyrën na e ka dhënë Zoti. Zoti na flet nëpërmjet natyrës. Është mëkat të shkatërrosh natyrën për hir të një çasti kënaqësie, apo për hir të një sasive të papërfillshme parash. Natyra që shkatërrojmë sot do të na kthehet nesër në formën e ndotjeve dhe do t'ua bëjë jetën të pamundur pasardhësve tanë. Ne duhet të kthehemi tek natyra dhe të dëgjojmë çfarë na thotë ajo. U thosha të rinjve të Amerikës se kur hapim zemrat dhe dëgjojmë çfarë na thotë natyra, mund të dëgjojmë fjalën e Zotit.

Në shtator të vitit 1975, ne themeluan Seminarin Teologjik të Unifikimit në Berritaun, që ndodhet në veri të qytetit të Nju Jork-ut. Fakulteti funksiononte mbi baza ndërfaqetare. Ne kishim profesorë që përfaqësonin judaizmin, protestantizmin, ortodoksinë lindore dhe filozofinë orientale. Kur jepnin leksione secili mbi fetë e tyre, studentët tanë u bënë atyre pyetje mjaft të vështira. Klasat gjithmonë ktheheshin në forume për debate intensive. Kur nisën të mblidheshin dhe të debatonin të gjitha fetë, filluan të thyheshin konceptet e gabuara që kishin për njëri-tjetrin dhe të kuptonin më saktë njëri-tjetrin. Të rinjtë e talentuar mbaruan studimet e masterit në seminarin tonë dhe hynë në programet për doktoraturë në Harvard, Jeil dhe universitete të tjera kryesore të ShBA-së. Sot ata janë bërë të aftë për të udhëhequr sferën e besimeve fetare në shkallë globale.

Monumenti i Uashingtonit, 1976



Në vitin 1974 dhe 1975 më ftuan të flas në Kapitol Hill. Fola përpara anëtarëve të Shtëpisë së Përfaqësuesve për temën “Një komb nën Zotin”.

Iu drejtova kongresmenëve njëllor sikur u drejtohesha të rinjve në rrugë, duke u thënë: “Amerika lindi në sajë të bekimit të Zotit. Sidoqoftë, ky bekim nuk është vetëm për amerikanët. Ai ishte bekimi që Zoti i dha botës nëpërmjet Amerikës. Amerika duhet të kuptojë parimin e këtij bekimi dhe duhet të sakrifkohet për të shpëtuar botën. Për këtë është e nevojshme të bëhet një rizgjim, që i lejon Amerikës të kthehet në shpirtin e themelimit të saj. Krishterimi, i cili ka qenë ndarë në dhjetëra degë, duhet të bashkohet, duhet të thithë të gjitha fetë dhe duhet të hapë një të ardhme të re për civilizimin botëror”.

Isha i pari nga udhëheqësit fetarë të huaj që u ftova për të folur në Kongresin e Shteteve të Bashkuara. Pasi u ftova për herë të dytë, shumë njerëz u bënë kuriozë të dinin se kush ishte ky, reverend Mun, nga Koreja.

Vitin tjetër, në 1 qershor të vitit 1976, ne organizuam një kremtim në stadiumin “Jenki” të qytetit të Nju Jork-ut, për të përkujtuar dyqind vjetorin e pavarësisë së Amerikës. Në atë kohë, ShBA nuk mund ta festonin përvjetorin e tyre paqësisht. Ajo po e ndiente kërcënimin e komunizmit dhe të rinjtë e saj po jetonin shumë larg dëshirës së Zotit, duke u dhënë

pas gjërave të tilla si droga dhe seksi i lirë. E ndjeva që Amerika ishte e sëmurë rëndë. Shkova në atë kremtim me ndjesinë sikur isha një kirurg që po hapja zemrën e Nju Jork-ut, që dergjej i sëmurë.

Ditën e kremtimit, binte shi i rrebeshtë dhe një erë e marrë i prishi të gjitha zbukurimet rreth e rrotull sheshit, por askush nuk u përpoq t'i fshihej shiut. Banda filloi të luajë “Ti je drita ime e diellit” dhe të gjithë në stadium filluan të këndojnë njëzëri. Po këndonin një këngë për diellin, megjithëse po bëheshin ujë nga shiu. Me gojët e tyre po këndonin për dritën e diellit por sytë e tyre po qanin. Ishte një çast në të cilin shiu dhe lotët u përzier. Pastaj, në mënyrë të pabesueshme, ndërsa shkoja në skenë për të folur, dielli doli midis reve. U duk sikur Zoti dëgjoi këngën e tyre.

Merresha nga pak me boks, kur isha në shkollë. Ju mund të godisni një boksier të mirë me shumë grushte dhe prapë ai duket se nuk i ka ndier ato. Por nëse i jepni një goditje të fortë të prerë nga sipër, edhe boksieri më i fortë do të shkundet. Po bëhesha gati t'i jepja Amerikës një goditje të fortë me prerje nga lart. Pata ndjesinë se duhej të mbahej një miting shumë më i madh se mitingjet e deriatëhershme, në mënyrë që emri “San Mjang Mun” të gdhendej në mënyrë të pashlyeshme në mendjen e Amerikës.

Uashingtoni është kryeqytet i Shteteve të Bashkuara. Monumenti i Uashingtonit ndodhet në shëtitoren National Mall, mu në qendër të kryeqytetit të ShBA-së. Monumenti, që duket si një laps i gjatë i mprehur ka një lartësi 183 metra. Një fushë e gjerë me bar shtrihet nga ky monument deri te memoriali i Linkoln-it. Bëra në plan të zhvilloja një miting të madh në këtë vend që simbolizon zemrën e Amerikës.

Por, që të mbanim një miting aty, na duhej leja nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe nga Policia e Parkut Kombëtar të Shteteve të Bashkuara. Në atë kohë, shumica e zyrtarëve amerikanë nuk më kishin shumë qejf. Pak kohë më parë unë kisha vënë njoftime në gazetë, duke i bërë thirrje popullit amerikan

të falte ish-presidentin Richard Nixon, që ishte shtyrë drejt krizës për shkak të incidentit “Uotergeit” (Watergate). Ky pikëshikim ishte krejt i panjohur. Prandaj qeveria e Shteteve të Bashkuara vazhdonte të na refuzonte; dhe ne, më në fund, mundëm të marrim leje vetëm dyzet ditë para zhvillimit të aktivitetit.

Edhe anëtarët tanë më sugjeruan se ky ishte tepër ambicioz si plan dhe se nuk duhet ta vazhdonim. Shëtitorja Nacionale që rrethonte monumentin e Uashingtonit ishte një park i hapur në mes të një zone urbane. Nuk kishte shumë pemë, vetëm një lëndinë e gjerë me bar. Nëse turma do të ishte e vogël, kjo do të ishte e dukshme për të gjithë. Për të mbushur një zonë kaq të madhe, duhej të ftoheshin me qindra mijëra vetë. Anëtarët tanë donin ta dinin si do të bëhej e mundur kjo gjë. Para kësaj, vetëm dy njerëz kishin zhvilluar ngjarje të mëdha në Shëtitorën Nacionale. Dr. Martin Luter King, i riu, ishte i pari që kishte zhvilluar një miting për të drejtat civile në shkallët e Përmendores së Linkoln-it dhe Rev. Billi Graham ishte i dyti që kishte mbajtur një takim të madh atje. Pra, ishte një vend me shumë kuptim. Ky ishte vendi që po sfidoja.

U luta pa pushim për këtë miting. E shkrova katër herë fjalimin që do të jepja. Një javë para aktivitetit, akoma kisha ndjenja të përziera rreth atyre që do të thosha gjatë fjalimit. Më në fund, tri ditë para ngjarjes, e përfundova tekstin. Zakonisht, nuk flas me tekst të përgatitur. Por në këtë rast bëra një përjashtim, për shkak të shqetësimit që kisha për mbarëvajtjen e kësaj ngjarjeje. E dija që kjo do të ishte një ngjarje veçanërisht e rëndësishme, megjithëse nuk isha i sigurt se në çfarë kuptimi.

Nuk do ta harroj kurrë çfarë ndodhi në atë ditë, 18 shtator 1976. Njerëzit filluan të vinin drejt monumentit të Uashingtonit që herët në mëngjes. U mblodhën rreth treqind mijë vetë. Ishte pothuajse e pamundur të thoshe se nga dolën të gjithë ata njerëz. Të gjithë kishin ngjyra të ndryshme flokësh dhe lëkure. Të gjitha racat që Zoti ka dërguar mbi tokë

u mbledhën atë ditë. Ishte një miting në shkallë globale, që nuk ka nevojë për asnjë lloj përshkrimi shtesë.

Qëndrova përpara tyre dhe deklarova: “Zoti e përgatiti Amerikën për dyqind vjet. Kjo është koha e zgjimit. Amerika duhet të pranojë përgjegjësinë e saj globale. E pajisur me Zotizmin, ajo duhet të çlirojë botën komuniste dhe më në fund të ndërtojë Mbretërinë e Zotit këtu në tokë”. Fjalimi u ndërpre shumë herë nga të thirrurat dhe duartrokitjet.

Revista Newsweek, në numrin e saj të fundvitit, një pasqyrë mbi ngjarjet kryesore të vitit 1976 të ilustruara me foto, kishte vënë fotografinë time dhe më referohej si pjesë e lëvizjes së ringjalljes¹ së viteve ‘70. Nga ana tjetër, një numër në rritje njerëzish kishin filluar të më shikonin me kujdes dhe me frikë. Për ta nuk isha asgjë më shumë se një magjistar i çuditshëm që kisha ardhur nga Lindja. Nuk isha një i bardhë ku mund të mbështesnin besimin dhe ta ndiqnin. Fakti që thosha gjëra disi të ndryshme nga ato që kishin dëgjuar në kishat e tyre, i bëri të ndiheshin të pasigurt. Në veçanti, ata nuk e lejonin dot një situatë në të cilën të rinjtë e bardhë po respektonin dhe ndiqnin një aziatik me sy të tërhequr si një peshk. Filluan të përhapin thashetheme se u kisha bërë lavash truri të rinjve të bardhë e të pafajshëm. Grupi që më kundërshtonte u mbledh në prapaskenë, prapa atyre që më mbështesnin. E dija që një krizë tjetër po bëhej gati të më godiste. Megjithatë nuk frikësohesha, sepse po bëja qartësisht atë që duhej.

Amerika është e njohur në masë si një vend i lirisë dhe i barazisë, ku njerëzit e të gjitha racave vijnë për të realizuar ëndrrën amerikane. Megjithatë, në fakt ekziston një numër i madh përleshjesh që rrjedhin nga diskriminimi racial dhe fetar. Ekzistojnë sëmundje kronike të ngulitura thellë në historinë e Amerikës dhe si të tilla ato janë shumë më të vështira për t’u kuruar se sëmundjet sociale,

¹ Në origjinal, “revivalism”: 1. (lat) formë e një veprimtarie religjioze, që shfaqet e rijetësuar; 2. tendenca për të rijetuar diçka ashtu siç ka qenë/përjetuar në të shkuarën; red.

si imoraliteti dhe materializmi, që lindën nga bollëku i viteve '70.

Në ato kohë po vizitoja kishat afro-amerikane në përpjekje për të nxitur harmoninë ekumenike. Midis udhëheqësve të zinj kishte disa, të cilët, ashtu si dr. Martin Lutter King i Riu, po punonin për shfuqizimin e diskriminimit racial dhe për të sjellë botën paqësore të Zotit.

Disa prej këtyre misionarëve kishin imazhe, të varura në bodrumet e tyre, të tregjeve të skllëverve që kishin ekzistuar për qindra vjet, para se të shpalleshin të jashtëligjshme. Një imazh i tillë ishte ai i një të ziu që po digej i gjallë i varur në një pemë. Një foto tjetër ishte ajo ku burra dhe gra me ngjyrë ishin ekspozuar të zhveshur si mall për tu blerë nga pronarë skllëverish. Ndërsa në një tjetër ishte një foshnjë e zezë që qante, ndërsa e ndanin nga nëna e vet. Nuk e beson dot njeri se qeniet njerëzore ishin të afta të kryenin veprime kaq barbare si ato që pasqyrohen kaq qartë në ato imazhe.

“Prisni dhe do të shihni”, thashë në një takim në Çikago në 24 tetor të vitit 1975. “Brenda tridhjetë viteve të ardhshme do të zgjidhet një president i Shteteve të Bashkuara që do të ketë lindur në një familje nga të bardhë e të zi.”

Profecia që kam thënë atë ditë është bërë realitet në Amerikë me inaugurimin e Presidentit Barak Obama, i cili ka kaluar shumicën e jetës së tij në Çikago. Kjo profeci nuk u realizua vetë. Shumë njerëz kanë derdhur gjak dhe djersë për të eliminuar mosmarrëveshjet midis racave dhe këto përpjekje më në fund kanë lulëzuar. Çuditërisht, një numër ministrash të kishave zyrtare në Amerikë erdhën dhe sollën me vete kongregacionin e tyre në tubimin e monumentit të Uashingtonit. Ata menduan se mesazhi im i kapërcente degëzimet fetare dhe se unë i frymëzoja të rinjtë. U bëja thirrje njerëzve të kapërcenin diferencimet e grupimeve dhe feve dhe ato fjalë u realizuan në atë tubim. Tubimi i monumentit të Uashingtonit ishte një mrekulli. Me një pjesëmarrje prej treqind mijë vetash, ai u bë një nga tubimet më të mëdha që është mbajtur ndonjëherë në shëtitoren kombëtare.

Mos qani për mua, por qani për botën



Pas një të mire zakonisht vjen një e keqe. Disa pikuruan mustaqe mbi fotografinë time duke u përpjekur ta krahasonin me Hitlerin. Më quajtën “anti-semit” dhe deklaruan se isha kundër hebrenjve. Telashe erdhën edhe nga të krishterët. Me rritjen e numrit të të rinjve që më ndiqnin dhe me rritjen e numrit të misionarëve që donin të mësonin “Parimin”, edhe kishat zyrtare të Amerikës filluan të më persekutonin. Më në fund, të majtët e Amerikës reagues kundër pozicionimit tim, sipas të cilit, Amerika ishte përgjegjëse për të ndaluar përhapjen e komunizmit në botë. Edhe ata filluan të gjenin mënyrën për të ndaluar aktivitetet e mia.

Me rritjen e popullaritetit tim, filluan të ngrihen lloj-lloj frikash e dyshimesh rreth meje. Të rinjtë, të frymëzuar për të përhapur mësimet e mia, kishin lënë shkollën ose punën për të udhëtuar rreth e qark vendit, për të mësuar dhe për të mbledhur fonde për punën tonë. Prindërit e tyre me të drejtë filluan të shqetësohen për mirëqenien e tyre.

Kur Shtetet e Bashkuara ishin ngatërruar me krizën “Uotergeit” unë u takova me presidentin Riçard Nikson dhe e nxita të kërkonte vullnetin e Zotit gjatë udhëheqjes së kombit. Unë i bëra apel popullit amerikan: “Për të falur, dashur dhe bashkuar” me presidentin. Kjo bëri të shpërthenin kundërshtime nga media majtiste. Gjëra që më parë nuk kishin qenë problem, befas filluan të rëndojnë mbi mua. Në të njëjtën kohë, konser-

vatorët thoshin se isha tepër liberal dhe se mësimet e mia do të shembnin vlerat tradicionale.

Shumë të krishterë nuk ishin të kënaqur me kuptimin e ri të kryqit që shpjegoja: Jezusi erdhi si Mesia dhe nuk ishte predestinimi i Zotit që ai të kryqëzohej. Me ekzekutimin e Jezusit, plani i Zotit për Mbretërinë e Paqes u shmang nga drejtimi i duhur. Nëse Izraeli do të kishte pranuar Jezusin si Mesi, ai do të kishte sjellë një botë të paqes, duke bashkuar kulturat dhe fetë e Lindjes dhe të Perëndimit. Megjithatë, Jezusi vdiq në kryq dhe puna e Zotit për shpëtimin e plotë u shty deri në Ardhjen e Dytë. Ky kuptim i kryqit solli një kundërshtim të madh. Për pasojë, kishat zyrtare, ashtu edhe komuniteti hebre, më konsideruan si armikun e tyre. U përpoqën në shumë mënyra të më përzinin nga Amerika, secili për arsytet e veta.

Më në fund u burgosa edhe njëherë. E gjithë puna ime kishte një qëllim: të rivendosja moralin e Amerikës dhe ta restauroja atë, si një vend në përputhje me vullnetin e Zotit, por ironikisht më akuzuan se nuk kisha paguar taksat. E kisha kaluar ditëlindjen time të gjashtëdhjetë në atë kohë.

Gjatë tre viteve të para në Amerikë, paratë e dhuruara nga anembanë botës ishin depozituar në një llogari bankare në Nju Jork në emrin tim, që mbaheshin në mirëbesim për kishën, një praktikë e përdorur zakonisht nga disa grupime fetare. Fondet në këtë llogari prodhuan të ardhura nga interesat dhe u akuzova për mosraportimin e atyre interesave si të ardhura personale në vitet 1973-1975. Taksa e përllogaritur për atë të ardhur (të paraportuar) ishte rreth 7500\$. Normalisht, mund të isha dënuar me një gjobë, por mua më çuan në gjyq dhe më fajësuan në vitin 1982 dhe përfundimisht më burgosën në burgun federal në Denburi, Conektikutit, në 20 korrik të vitit 1984.

Një ditë para se të paraqitesha në burgun e Denburit, u takova me anëtarët që ishin mbledhur në qendrën e trajnimit në Belvedere Tarritaun,

Nju Jork. Ishte një takim prekës. Me mijëra njerëz që më kishin ndjekur u mblodhën në Belvedere atë ditë. Ata derdhën lot, dhe u lutën për mua. E ngrita zërin dhe u thashë të mos humbnin shpresën.

“Jam i pafajshëm,- u thashë.- Nuk kam bërë asgjë të keqe. Mund ta shoh dritën e fortë të shpresës që vjen përtej Denburit, u thashë. Mos qani për mua, por qani për Amerikën. Duajeni Amerikën dhe lutuni për të.” Qëndrova para këtyre të rinjve të zhytur në hidhërim dhe ngrita duart lart në shenjë shprese.

Deklarata që bëra para se të hyja në burg shkaktoi një trazim të madh në mes të përfaqësuesve të besimeve. U krijua “Shoqëria e Vuajtjes së Përbashkët” që organizoi një zinxhir lutjesh për të më mbështetur mua. Shoqëria e Vuajtjes së Përbashkët ishte një forcë mbështetëse e klerikëve nga të gjitha degëzimet (e krishterimit) dhe nga besime të tjera, të shqetësuara për sulmin mbi lirinë fetare në Amerikë.

Ditën që shkova në burg, e dija se nuk kisha pse të frikësohesha. E njoh jetën në burg. Por nuk ishte e njëjta gjë për njerëzit që më rrethonin. Ata ishin të shqetësuar se ndonjëri që më kishte kundërshtuar me forcë, do të ndërmernte ndonjë veprim për të më hequr qafe. U nisa drejt burgut me kokën lart.

“Pse duhet të shkojë në burg babai im?”



Edhe kur isha në burg, ndoqa parimin tim të të jetuarit për të tjerët. Ngrihesha herët në mëngjes dhe pastroja vendet e papastra. Në kafeteri, të tjerët shtriheshin mbi ushqimin e tyre dhe dremisnin ose bënin muhabet me njëri-tjetrin, ndërsa unë e mbaja kurrizin drejt dhe ulesha me dinjitet. Kur më jepnin të bëja ndonjë punë, punoja më shumë se të tjerët dhe e mbaja një sy hapur për të parë si punonin ata. Në kohën e lirë lexoja Biblën. Një i burgosur, duke parë se e lexoja Biblën natë e ditë, më tha: “Ajo është Bibla jote? Bibla ime është kjo. Hidhi një sy!” Më hodhi një revistë. Ishte revista pornografike “Hastler”.

Në burg, njihesha si njeriu që punonte pa folur. Lexoja libra dhe meditoja. Pasi kalova tre muaj në këtë mënyrë, u bëra shok me të burgosurit dhe rojet. U miqësova me dikë që merrej me drogë dhe me të burgosurin që më kishte thënë se Bibla e tij ishte revista pornografike. Pas nja dy muajsh, të burgosurit filluan të ndanin me mua artikujt që u sillnin nga jashtë. Kur filluam të ndanim zemrën me njëri-tjetrin, ishte sikur të kishte ardhur pranvera në mjediset e burgut.

Në fakt, qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk donte të më fusnin në burg. Zgjodhën të më padisnin ndërsa isha jashtë vendit në një udhëtim në Gjermani dhe do të kishin qenë të kënaqur nëse vendosja të mos kthehesha. Nuk po përpiqeshin të më fusnin në burg, po përpiqeshin

të më nxirrnin nga vendi. Po bëhesha shumë i njohur në Amerikë dhe numri i njerëzve që më ndiqnin ishte në rritje. Pra, donin të vinin një pengesë në rrugën time. Ashtu si në Kore, unë u bëra si një gjemb në brinjë të kishave zyrtare. Duke e ditur se ky ishte qëllimi i tyre, zgjodha të kthehem në Amerikë dhe të shkoj në burg. Kisha akoma gjëra për të bërë në Amerikë.

Mendoj se të shkosh në burg nuk është një gjë krejtësisht e keqe. Nëse detyra ime është t'i bëj të pendohen njerëzit që ndodhen në luginën e lotëve, atëherë duhet të jem i pari që derdh lot. Po qe se unë nuk e përjetoj i pari këtë zemër kaq të vuajtur, nuk i bëj dot të tjerët t'i nënshtrohen Zotit. Qielli punon në mënyra vërtet misterioze. Pasi u burgosa, shtatëmijë misionarë dhe udhëheqës të tjerë fetarë akuzuan qeverinë e Shteteve të Bashkuara për dhunimin e lirive fetare dhe filluan përpjekjet për të më shpëtuar. Midis tyre ishte udhëheqësi konservativ i krishterë Rev. Xherri Faluell i Kuvendit Baptist të Jugut dhe ai liberal dr. Xhozef E. Loueri, i cili dha bekimin gjatë inaugurimit të Presidentit Obama. Ata qëndruan në ballë të përpjekjeve për të më shpëtuar mua. Gjithashtu, edhe vajza ime In Xhin, një vajzë ende në adoleshencë, qëndroi përkrah tyre. Ajo u ngrit para shtatëmijë udhëheqësve fetarëve dhe lexoi e përplotur një letër me anë të së cilës i bënte thirrje gjykatësit që kishte dhënë vendimin për mua.

“Jeta e babait tim ka qenë e shënuar me lot dhe vuajtje ndërsa kërkonte të kryente Vullnetin e Zotit. Tani ai është 64 vjeç. Krimi i vetëm i tij është se ai e deshi Amerikën. Megjithatë, në këtë çast, ai ose po lan enët në kafenenë e burgut ose pastron dyshemetë e tij. Javën e kaluar i bëra një vizitë babait tim dhe e pashë për herë të parë me uniformën e burgut. Qava e qava. Babai im më tha që të mos qaja për të, por të lutesha për Amerikën. Ai më tha ta ktheja inatin dhe brengën në një forcë të madhe, që mund ta bëjë këtë një vend vërtet të lirë. Ai tha se në burg do të kapërcente çdo

vështirësi, do të duronte çdo padrejtësi dhe do të mbante çdo kryq. Liria e besimit është themeli i të gjitha lirive. U jam vërtet mirënjohëse atyre që janë ngritur në mbështetje të lirisë së besimit.”

Dënimi im u shkurtua gjashtë muaj për sjellje të mirë, kështu që u lirova pasi vuajta trembëdhjetë muaj në burg. Ditën që u lirova u mbajt një banket në Uashington D.C. për të festuar këtë ngjarje. Shtatëqind ministra të krishterë dhe rabinë hebrenj ishin mbledhur dhe më prisnin. Në fjalën time para tyre, unë përsërita pozicionimin tim në favor të kapërcimit të feve dhe degëzimeve. Fola më zë të lartë për botën mbarë, duke mos pasur nevojë të shqetësohem për reagimin e atyre që qenë kundër meje.

“Zoti nuk është një qenie që i përket një dege apo sektit të caktuar. Ai nuk është i lidhur pas diskutimeve dytësore mbi doktrinën. Nuk ka dallime kombëtare apo racore në zemrën prindërore të Zotit. Në zemrën e Tij nuk ka as mure ndërmjet kombeve apo kulturave. Madje, edhe sot, Zoti vazhdon të bëjë gjithçka që mundet për të përqaftuar gjithë popujt e botës si fëmijët e Tij. Amerika sot vuan prej çështjeve raciale, çështje që rrjedhin nga konfuzioni i vlerave dhe degjenerimi moral, çështje të thatësisë shpirtërore, të rënies së besimit të krishterë dhe çështjet e komunizmit ateist. Këto janë arsyt pse iu përgjigja thirrjes së Zotit dhe erdha në këtë vend. Krishterimi sot duhet të ketë një zgjim madhështor dhe të bashkohet në një. Edhe klerikët, gjithashtu duhet të rishqyrtojnë rolet që kanë luajtur deri tani dhe të pendohen. Situata që u pa 2000 vjet më parë kur erdhi Jezusi dhe u bëri thirrje njerëzve të pendohen, po përsëritet edhe sot. Ne duhet të përmbushim misionin e rëndësishëm që Zoti i ka dhënë Amerikës. Situata nuk mund të vazhdojë siç është tani. Nevojitet një reformë e re.”

Pasi u lirova nga burgu, nuk kishte gjë që më ndalte. Fola me një zë edhe më të lartë se më parë për t'i dhënë një paralajmërim Amerikës së

rënë. Flisja vazhdimisht me fjalë të forta se kthimi tek Dashuria e Zotit dhe morali është e vetmja rrugë për të ringjallur Amerikën.

U burgosa pa bërë asgjë të keqe, por Vullneti i Zotit ishte edhe atje. Pas lirimit tim, njerëzit që punuan për këtë filluan të vijnë me radhë në Kore, që të mësonin më shumë rreth punës sime. Arritën të zbulojnë se çfarë kishte shpirti i reverendit Moon që kishte tërhequr kaq shumë të rinj në Amerikë. Me t'u kthyer në Shtetet e Bashkuara, 120 prej këtyre ministrave të krishterë organizuan Konferencën e Udhëheqësve Klerikë Amerikanë.

faqe bosh